



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Construmax shpk" të datës 28.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therretores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Construmax shpk" të datës 28.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therretores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Construmax shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 28.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therretores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "PRETENDIMI 1 - LIDHUR ME ARSYET ELIMINUES TË KONSORCIUMIT TONË: Të gjitha këto arsye eliminimi janë të tilla për të cilat, në ankesën tonë drejtuar OSHP-së, është konstatuar se eliminimi ynë është bërë pa arsye të vlefshme. Ekspertiza ka sqaruar në detaje se të gjitha dëshmitë e prezantuara nga ne kanë qenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dosjen e Tenderit (DT). Mirëpo, ju keni eliminuar

Faqe 1 nga 13

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000  
Tel.: 038-200-40-111  
Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)

kompaninë tonë bazuar në dëshmi që nuk ishin kërkesa në DT, dhe fakte të rrejshme dhe manipulative. Arsyetimet eliminuese nga rivlerësimi: „ARSYETIM Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Juve si GOE-ik ju mungon garancioni për min. 1 vit nga prodhuesi për pozicionet sipas kërkesës nr. 6 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit. AK ka kërkuar nga OE sqarime shtesë sipas vendimit OSHP:2024/0001 të datës 15.04.2024. OE ka kthyer sqarime shtesë me ç'rast ka bashkangjitur autorizime nga prodhuesi ESADPANEL, Seferi Group, ZGSM Technology, Engoffice dhe Proklima. Megjithatë OE së bashku me ofertën e tij ka dorëzuar katalogjet e prodhuesve të tjerë siç janë V-TAC Europe, Halcor, Sinostar, Saint Gobain, Eurofisi, ORCA, Mario Dorin, GREE, Reventon, Haier, etj. Pra OE ka dorëzuar katalogjet e prodhuesve të tjerë dhe ka dorëzuar autorizime nga krejt prodhues të tjerë. Prandaj OE nuk ka dorëzuar garancionin e prodhuesit për 1 vit sipas kërkesës nr. 6 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit. 3. Dyert e frigodhomave pozicionet në BoQ 12.11-12.18 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë të skeduar afatet. 4. Dritaret pozicioni në BoQ 12.1-12.10 ISO 9001 e skaduar (01.04.2015) dhe certifikata vetëm në gjuhën polake. 5. VRF pozicioni në BoQ 29.11-30.1 ISO 9001 e skaduar, autorizimi nuk është i dhënë as nga prodhuesi e as nga distributori i autorizuar (është i dhënë nga Service provider), \*Certifikata e EUROVENT është e skaduar 31.07.2020, \*Në autorizimin e prodhuesit (distributorit) nuk është cekur titulli projektit, numri prokurimit si dhe nuk ka date të autorizimit. 6. Gypat për ujësjellës pozicioni në BoQ 17.8-17.10 → autorizimi nga distributori nuk ka date të leshimit. 7. Njësit për friza pozicioni në BoQ 28.1-28.14 ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë të skeduar afatet (01.06.2022). Komisioni i rivlerësimit bazuar në rekomandimet e dhëna në Vendimin e OSHP-se me nr: OSHP: 2024/0001 ka kërkuar sqarime shtesë përmes letrës standarde B47 me datë 12.08.2024 dhe brenda afatit kohorë të përcaktuar në B47 GOE-ik është përgjigjur në sqarime. Komisioni i rivlerësimit është mbledhur dhe pas shqyrtimit të përgjigjeve të OE-ik komisioni konstaton se përgjigjet e dërguara të datës 14.08.2024 nga OE-ik nuk janë bindëse sipas DT-se, njoftimit për kontrate, dhe ofertës së dorëzuar nga OE-ik.”

Konsiderojmë se këto arsyetime janë të bazuara në fakte të rreme dhe të manipuluar. Ju si Autoritet Kontraktues keni bërë kërkesë për sqarime të dërguara kompanisë tonë më datën 12.08.2024, duke kërkuar sqarime për dy kërkesa: Kërkesa nr. 1: Në dosjen e tenderit është përcaktuar kërkesa e dosjes së tenderit si në vijim “Garancioni min. 1 vit nga prodhuesi për pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 16.10, 16.12, 26.5, 29.1, 29.11, 19.15, 30.1” ndërsa si dëshmi dokumentare është përcaktuar si në vijim “OE duhet të ofroj një deklaratë të vulosur dhe nënshkruar për garancionin nga prodhuesi min. 1 vit për pozicionet e kërkuara”. Ju në ofertën tuaj keni dorëzuar një deklaratë të nënshkruar nga ju si tenderues mirëpo nuk keni bashkangjitur garancionin e prodhuesit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Prandaj në përputhje me vendimin OSHP:2024/0001 të datës 15.04.2024, AK kërkon nga ju që të dërgoni garancionin e prodhuesit sikurse është përcaktuar me dosjen e tenderit. Kërkesa nr. 2: Në ofertën tuaj ju keni dorëzuar dokumentet si në vijim: - Për dyert e frigodhomave → pozicionet në BoQ 12.11-12.18 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë me afat të skaduar. - Për dritaret → pozicioni në BoQ 12.1-12.10 → certifikata ISO 9001 është me afat të skaduar (01.04.2015) po ashtu certifikata është vetëm në gjuhën polake. - VRF → pozicioni në BoQ 29.11-30.1 → ISO 9001 e skaduar, autorizimi nuk është dhënë as nga prodhuesi por as nga distributori i autorizuar (është dhënë nga Service provider), \*Certifikata e EUROVENT është e skaduar 31.07.2020, \*Në autorizimin e prodhuesit (distributorit) nuk është cekur titulli projektit, numri prokurimit si dhe nuk ka datë të autorizimit. - Gypat për ujësjellës → pozicioni në BoQ 17.8-17.10

→ autorizimi nga distributori nuk ka datë të lëshimit. - Njësitë për friza → pozicioni në BoQ 28.1-28.14 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë me afat të skaduar (01.06.2022). Prandaj AK kërkon që ju të dorëzoni certifikatat ISO me afat të vlefshëm dhe në gjuhën e pranuar për prokurimin publik në Republikën e Kosovës si dhe dokumentet tjera me përmbajtjen e përcaktuar me dosje të tenderit sikurse përkitazi me sqarimet më sipër. Ne si kompani kemi dorëzuar sqarimet e kërkuara më datën 14.08.2024, duke prezantuar të gjitha dëshmitë e kërkuara në dy shkresa: • [Prov. Shkresa 1] – Sqarimet nga Construmax lidhur me letrën standarde për sqarime shtesë të datës 12.08.2024 • [Prov. Shkresa 2] – Sqarimet nga Construmax lidhur me letrën standarde për sqarime shtesë të datës 12.08.2024 Në shkresën e parë kemi prezantuar të gjitha garancionet e kërkuara dhe certifikatat në gjuhë zyrtare dhe me validitet para hapjes së ofertave, duke përfshirë edhe autorizimet dhe sqarimet e nevojshme. Në shkresën e dytë kemi prezantuar certifikatat e kërkuara, duke dëshmuar që prodhuesit kanë certifikata të vlefshme edhe në këtë kohë. Ju si ZPP pas sqarimeve të kërkuara të cilat keni qenë të obliguar të kërkonit ngs vendimit të OSHP-së nr.2024/0001 që ka konstatuar se eliminimi i OE Construmax Sh.P.K, në fazën e parë vlerësuese është bërë padrejtësisht dhe në kundërshtim me gjendjen faktike. Pas prezentimit të sqarimeve tona në pamundësi për eliminim të kompanisë tonë, keni eliminuar ofertën tonë në kundërshtim të plotë me gjendjen faktike me njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të Komunës së Prishtinës me datë 23.08.2024. Se vendimi është nxjerrë në kundërshtim të plotë me gjendjen faktike dëshmohet edhe me dokumentet e dorëzuara e ofertë nga ana jonë ku janë prezentuar 25 foldera së bashku me ofertë financiare, ku janë prezentuar autorizime, kataloge, garancione, test raporte dhe enex, iso, ce, deklarata dhe Eurovent. [Prova: Formulari për dorëzim të tenderit].

Në kërkesën 4 të Dosjes së tenderit është kërkuar autorizimi nga prodhuesi ose distributori i produktve për 25 pozicione të paramasës (pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 16.10, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 19.15, 26.5, 29.1, 29.11,30.1). Në kërkesën 5 të Dosjes së tenderit kan qenë të kërkuar katalogë nga prodhuesit për 69 pozicione të paramasës, ( pozicionet 7.1, 7.2, 8.2, 8.3, 9.1, 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.6, 12.7, 12.8, 12.9, 12.10, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18, 13.1, 16.10, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 23.1, 23.2, 23.3, 23.4, 26.5, 28.1, 28.2, 28.3, 28.4, 28.5, 28.6, 28.7, 28.8, 28.9, 28.10, 28.11, 28.12, 28.13, 28.14, 28.18, 29.1, 29.11, 29.14, 29.15, 30.1, 30.2.) Në kërkesën 6 të Dosjes së tenderit kan qenë e kërkuar garanconi minimum 1 vie për 14 pozicione të paramasës (pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7,16.10, 16.12, 26.5, 29.1, 29.11, 19.15, 30.1.) [Prova - renditja e dokumentacionit të Autorizimeve, Katalogeve, Garancionit, TestRaport dhe ENEC, Iso CE, Deklaratat, Eurovent] Duke u bazuar që në kërkesën e 5 të Dosjes së tenderit në të cilën janë kërkuar katalogë për 69 pozicione, ne kemi prezentu për të gjitha këto pozicione kataloge, ndërsa autorizime kemi prezentu vetëm për 25 pozicionet e paramasës për të cilat kemi prezentu edhe kataloget e të të njetëve prodhues ashtu siç ka qenë kërkesa 4 e Dosjes së tenderit. Po ashtu, ne kemi prezentu garancionin vetëm për 14 pozicionet e kërkuara në kërkesën e 6 të dosjes së tenderit të prodhuesve të njejtë nga të cilët kemi pasur autorizimin dhe kataloget. Për të qartësuar që arsyet eliminues nga ju si AK që janë me fakte të rrejshme dhe manipulative, prezentojmë kërkesat e Dosjes së Tenderit ne formen tabelare dhe Renditjen e dokumenteve në foldera të dorëzuara me ofertë Në rastin konkret Komisioni apo udhëheqësi i prokurimit nuk ka vërtetuar drejtë duke evidentuar emërtime të prodhuesve që kemi prezentuar në kataloget e 69 pozicioneve që kan qenë kërkesa 5 e Dosjes së tenderit (emërtime të disa prodhuesve që kem prezentu katalog, që nuk ka

qenë kërkesa për autorizim për ato pozicione), dhe Komisioni apo Udhëheqësi i Prokurimit ka fshehur që autorizimet tona janë në përputhje me kërkesën 4 të dosjes së tenderit për 25 pozicionet e kërkuara. Po ashtu, Komisioni apo Udhëheqësi i Prokurimit, ka fshehur sqarimet që kemi dorëzuar për garancionet e prodhuesit min 1 vjeqare që janë për 14 pozicionet e kërkuara në Dosjen e tenderit. Duke u bazuar në rrjedhën e gjendjes faktike të përshkruar me lartë, shihet se Komisioni Vlerësues dhe ZPP-jat – përveç shkeljeve të ligjeve relevante – me veprimet e tyre na keni shkaktuar dëme, të cilat konsiderojmë që paraqesin shkelje të KPRK-së. Të njëjtit – supozojmë që keni kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, Neni 414, paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili shprehimisht parasheh si në vijim: “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”.

Autorizimet janë të ngarkuara në e-prokurim në folderin 8.0 1. Autorizimi nga prodhuesi ESADPANEL per pos 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7 • Prov - Dëshmi që kataloget janë të njëjtit prodhues që kemi prezentuar edhe autorizimin - Kataloget e prodhuesit të Esad panel, per këto pozicione janë në folderin 7.0 kataloget - Poz 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7 S. Panellat • Prov - Leter of Guarantee nga Esad Panel – te dërguar me sqarime e kërkuara 2. AUTORIZIMI nga prodhuesi Seferi Group shpk per pos 16.10 dhe 16.12 Prov - Dëshmi që kataloget janë të njëjtit prodhues që kemi prezentuar edhe autorizimin - Kataloget e prodhuesit të Seferi Grup shpk, per këto pozicione janë në folderin 7.6 kataloget - POZ 16.10 DHE 16.12 • Prov - Garancion nga prodhuesi nga Seferi Group- te dërguar me sqarime 3. Autorizimi nga distributori TermoON per pos 17.8,17.9,17.10 • Prov - Dëshmi që kataloget janë të njëjtit distributor që kemi prezentuar edhe autorizimin - Kataloget e distributorit TermoON, per këto pozicione janë në folderin 7.6 kataloget - Poz 17.8,17.9 dhe 17.10 Gypat • Nuk ka pas kërkes për garancion për këto produkte në Dosje të tenderit 4. Autorizimi nga prodhuesi FerPlast per pos 19.1,19.2,19.3,19.4,19.5,19.6,19.7,19.8 • Prov - Dëshmi që kataloget janë të njëjtit prodhues që kemi prezentuar edhe autorizimin - Kataloget e prodhuesit Ferplast, per këto pozicione janë në folderin 7.6 kataloget - Poz 19.1 deri 19.8 Gypat • Nuk ka pas kërkes për garancion për këto produkte në Dosje të tenderit 5. Autorizim nga prodhuesi Hangzhou ZGSM Technology CO.,Ltd per pos 26.5 • Prov - Dëshmi që kataloget janë të njëjtit prodhues që kemi prezentuar edhe autorizimin - Kataloget e prodhuesit Hangzhou ZGSM Technology CO.Ltd, per këtë pozicione janë në folderin 7.2 kataloget - Poz 26.5 drita e jashtme • Prov - Leter of Guarantee nga Hangzhou ZGSM Technology CO.,Ltd – te dërguar me sqarime 6. Authorization nga prodhuesi ProKLIMA per pos 29.1 • Prov - Dëshmi që kataloget janë të njëjtit prodhues që kemi prezentuar edhe autorizimin - Kataloget e prodhuesit ProKLIMA, per këtë pozicione janë në folderin 7.8 kataloget - Poz 29.1 • Prov - Leter of Guarantee nga ProKLIMA – te dërguar me sqarime 7.1. Authorized nga distributori engoffice pos 29.11 dhe 30.1 • Prov - Dëshmi që kataloget janë të njëjtit prodhues që kemi prezentuar edhe autorizimin - Kataloget e Dealer Certificate Engoffice, per këtë pozicione janë në folderin 7.10 kataloget - Poz 29.11 dhe 30.1 Reupatori dhe VRF • Prov - Garancion nga dealer i autorizuar engoffice- te dërguar me sqarime Bazuar në sqarimet dhe provat e prezantuara, konsiderojmë se Komisioni i Vlerësimit dhe ZPP-ja kanë dhënë arsye të rreme, duke krijuar konfuzion për të vendosur Panelin Shqyrtues në lajthitje, me qëllim që vendimi juaj për dhënien e kontratës të mbetet në fuqi.



PRETENDIMI 3 – TRAJTIMI I GJETJEVE TË ALFA I Alfa I ka disa gjetje të cilat nuk janë trajtuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, dhe këto gjetje nuk janë trajtuar as nga ju si Autoritet Kontraktues (AK). Ne, me datën 26.04.2024, i kemi dërguar një shkresë zyrtare OSHP-së për trajtimin e të gjitha pretendimeve ndaj Alfa I shpk, por deri më tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Gjetja e Parë – OE Alfa I Ky OE ka vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit në mënyrë retroaktive. Ky ofertues bazuar në dokumentet e ofruar në qasje rezulton se nga data 23.02.2024 deri me 03.07.2024 nuk ka pasur sigurim të tenderit. Sipas nenit 40 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), nenit 30 të Rregullores për Prokurim Publik, dhe duke u mbështetur në interpretimin ligjor të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik (KRPP) me nr.7 të datës 22.11.2022, vazhdimi i validitetit të ofertave duhet të bëhet para skadimit të afatit të validitetit të ofertave. KRPP-ja ka theksuar se „asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës“, dhe zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit nuk mund të kërkohet në mënyrë retroaktive. Duke pasur parasysh këtë, konsiderojmë se ky ofertues është i papërgjegjshëm. Gjetja e Dytë – OE Alfa I OE Alfa I nuk plotëson kërkesën lidhur me trupin triques të pozicionit 26.5, pasi në kataloget e këtij prodhuesi nuk ka reflektor ndriçues me 100 We as 150 LM/W, dhe as shpërndarjen e dritës prej 25 107 W 157 LM/W. Po ashtu, ky produkt nuk i plotëson kërkesat për rezistencën në temperaturë dhe nuk ka mbrojtjen IP 66 të kërkuar, por ka vetëm IP 65. Ky OE ofertues është i papërgjegjshëm për faktin që ka prezantuar një produkt që nuk është në përputhje me specifikimet e kërkuara në BoQ dhe në projekt, dhe i mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara. Gjithashtu, ju si Autoritet Kontraktues, sipas Udhëzimit nr. 001/2023 për Prokurim Publik, neni 10, në momentin që nuk ka përmbushje të specifikacionit teknik të kërkuar në katalogë, do të duhej të refuzoni ofertën pa kërkuar sqarime. Në kundërshtim me këto dispozita, keni kërkuar sqarime shtesë për produkte që i mungonte specifikacioni teknik i kërkuar. Citoj pjesë nga tabela e udhëzuesit bazuar në nenin 10 të Udhëzimit nr. 001/2023 për Prokurim Publik: Prov : konstatimi i ekspertizës për këto pozicione që nuk përmbush specifikat e kërkuara

Gjetja e Tretë – OE Alfa I OE Alfa I është i papërgjegjshëm për faktin se materialet e prezantuara nuk përmbushin specifikat e kontratës dhe kërkesat e Dokumentacionit të Tenderit (DT) lidhur me katalogët dhe specifikat e materialeve. Këto mangësi janë evidentuar në formën tabelare të bashkangjitur kësaj kërkesë për rishqyrtim në „Tabela e Gjetjeve të Ofertuesëve“ dhe përfshijnë: 1. Pos 11.1 deri në 11.7 nga BoQ: o Prodhuesi që ka autorizuar Alfa I nuk ka Certifikat ISO 10002:2018. Katalogu i prezantuar nga prodhuesi nuk plotëson specifikat e kërkuara për këto pozita. 2. Pos 13.1: 13/18 o Katalogu dhe specifikat e izolimit termik (EPS & XPS) nuk përmbushin specifikat e kërkuara në këtë pozicion. 3. Pos 16.10 dhe 16.12: o Nuk është prezentuar Test Raport për pllaka sipas EN 12390-8. Për më tepër, është dorëzuar Test Raport për një standard tjetër (EN 12390-3), që nuk përputhet me kërkesat e DT-së. 4. Pos 23.1 deri në 23.4: o Nuk janë prezentuar katalogë për këto pozita ashtu siç ka qenë në kërkesë të DT-së. 5. Pos 26.5: o Trupi ndriçues i prezentuar në katalog nuk përmbush kërkesat dhe specifikat e kërkuara në BoQ dhe DT. Përfundim: Produktet e propozuara nga OE Alfa I nuk janë të përputhshme me specifikat e BoQ dhe DT. Ky OE nuk ka dorëzuar katalogë të kërkuar, nuk ka paraqitur test raporte dhe materialet e prezantuara nuk përmbushin specifikimet teknike të kërkuara. Këto mangësi rrezikojnë funksionimin e projektit dhe prandaj oferta e këtij OE duhet të refuzohet. Gjetja e Katërt – OE Alfa I OE Alfa I është i papërgjegjshëm për faktin se nuk ka dorëzuar planin dinamik në përputhje me kërkesat e Dokumentacionit të Tenderit (DT). Ky plan dinamik është i paplotë dhe nuk përputhet me pozicionet e listuara në BoQ, duke krijuar një pasqyrë të pasaktë të implementimit të projektit. Më

poshtë janë evidentuar mangësitë specifike: 1. Mangësi në Evidentimin e Pozicioneve: o Plani dinamik paraqet vetëm 65 pozicione për realizim, ndërkohë që BoQ liston 370 pozicione. Ky diferencë sugjeron se OE Alfa I nuk do të implementojë të gjitha pozicionet e kërkuara dhe do të përgjigjet vetëm për një pjesë të vogël të tyre. 2. Përshkrime të Pashpjegueshme: o Pozicionet 1 deri në 4: Këto pozita nuk janë përfshirë në planin dinamik. o Pozicioni 4: Në planin dinamik, ky pozicion është kategorizuar si Punë të Betonit dhe Betona Armës, ndërsa në BoQ është specifikuar për Armaturën. o Pozicioni 5.0: Në planin dinamik, ky pozicion është kategorizuar si punë muratore dhe Sandwich Panel, ndërsa në BoQ është specifikuar për Punët e Konstruksioneve Metalike. 3. Përputhshmëria e Planit Dinamik: o Plani dinamik i dorëzuar është i paqartë dhe nuk përmbush kërkesat për të evidentuar të gjitha pozicionet e projektit në përputhje me BoQ dhe DT. Ky plan është thelbësor për vlerësimin e ofertës, dhe mungesa e detajeve të nevojshme ka ndikuar në procesin e poentimit. Përfundim: Plani dinamik i paraqitur nga OE Alfa I është i paplotë dhe i pasaktë në përputhje me kërkesat e vendosura në DT dhe BoQ. Për këtë arsye, OE Alfa I duhet të eliminohet nga procesi i tenderit pasi plani dinamik nuk reflekton pozitat e kërkuara dhe nuk përmbush kriteret e kërkuara për vlerësim. Rekomandim: Si Autoritet Kontraktues (AK), është e nevojshme të eliminoni këtë ofertues për shkak të mangësive në planin dinamik që ndikon në përputhshmërinë e tij me kërkesat e DT dhe BoQ.

Gjetja e Gjashtë- OE Alfa I OE Alfa I është i papërgjegjshëm për arsye se, nga 4 kamionë të tonazhit 20-30 tonë të kërkuar në Dokumentacionin e Tenderit (DT), ka prezantuar vetëm një kamion të këtij tonazhi. Andaj, konsiderojmë që ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk ka arritur të prezantojë 4 kamionë me tonazhin e kërkuar në DT.

Gjetja e Shtatë – OE Alfa I OE Alfa I është i papërgjegjshëm për faktin që nuk ka prezantuar kamionin me korpë, siç ka qenë e kërkuar në Dokumentacionin e Tenderit (DT). Në vend të kamionit të kërkuar, ka prezantuar një kamionetë që nuk i përmbush specifikimet e kërkuara. Kërkesa në DT ishte për: • Kamion me korpë (detajet specifike të kërkuara në DT) Gjetja e Tëtë – OE Alfa I OE Alfa I është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk ka prezantuar test raportin sipas standardit EN 12390-8 për muret L dhe pllakat e betonit, siç është kërkuar në Dokumentacionin e Tenderit (DT). Ky dokument është thelbësor për të verifikuar cilësinë dhe përputhshmërinë e materialeve të ofruara, dhe mungesa e tij është një shkelje e rëndësishme e kërkesave të tenderit. Gjetja e Nëntë – OE Alfa I OE Alfa I është i papërgjegjshëm për faktin që nuk ka prezantuar specialist të mjedisit siç është kërkuar në kërkesën 2 të Dokumentacionit të Tenderit (DT), që kërkon kualifikime shkollore dhe profesionale për personelin udhëheqës. Në vend të një specialisti të licencuar nga Ministria përkatëse e mjedisit, OE ka prezantuar z. H... J..., i cili është inxhinier i ndërtimit dhe nuk është specialist i mjedisit. Në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, vetëm personat e licencuar nga Ministria e Mjedisit kanë drejtën për të bërë raporte mjedisore dhe për të operuar si specialistë në këtë fushë. Për të krahasuar, specialistët e konzorciumit tonë dhe specialisti i Limit Projekt kanë licencë të vlefshme për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) nga Ministria. Ky detaj është thelbësor, pasi personi i prezantuar nga OE Alfa I nuk ka licencë për të realizuar raporte mjedisore dhe nuk mund të konsiderohet si specialist (ekspert) mjedisor sipas ligjit. Bashkangjitur gjeni pjesë të Ligjit Nr. 08/L-181, që rregullon licencimin dhe përgatitjen e raporteve mjedisore: Pjesë të Ligjit Nr. 08/L-181 • [Pjesa e Ligjit për licencimin e specialistëve të mjedisit dhe detyrat e tyre] Në përfundim, OE Alfa I nuk i ka përmbushur kërkesat e DT për specialistët e mjedisit, dhe për këtë arsye është i papërgjegjshëm. Pas një shqyrtimi të detajuar të dokumentacionit të dorëzuar nga OE Alfa I, është e qartë se ky ofertues nuk ka përmbushur disa kërkesa të rëndësishme të Dokumentacionit Teknik (DT). Ky OE

ka dështuar në plotësimin e kushteve për të qenë Gjetja e Dhjetë – OE Alfa I OE Alfa I është i papërgjegjshëm për faktin që Deklarata nën Betim e dorëzuar nuk është në përputhje me formatin standard të kërkuar dhe nuk specifikon qartë për cilin projekt apo numër të prokurimit është dorëzuar. Forma e deklaratës që është paraqitur nuk përmbush kërkesat e nevojshme për të garantuar përgjegjësitë e kërkuara në këtë procedurë tenderi. Deklarata nën Betim e dorëzuar nga OE Alfa I është:

- Jashtë formatit të duhur: Deklarata nuk përputhet me formatin standard të kërkuar për deklaratat nën betim, duke e bërë atë të papranueshme për qëllimet e kësaj procedure.
- Pa detaje specifike: Nuk ka informacione të qarta që lidhen me projektin konkret ose numrin e prokurimit, duke lënë hapësirë për keqkuptime dhe mos përmbushje të kërkesave të projektit.
- Pa përmbushur kërkesat ligjore: Kjo deklaratë nuk garanton përmbushjen e përgjegjësiave ligjore që janë të nevojshme për ofertën e dorëzuar nga OE. Andaj, ju si Autoritet Kontraktues duhet të eliminoni OE Alfa I nga procedura e tenderit për shkak të mos përmbushjes së Kushtit Administrativ, pasi që ka dorëzuar një deklaratë nën betim që nuk përmbush kërkesat e nevojshme për këtë projekt dhe nuk siguron përgjegjësitë e kërkuara ligjore. Prov: Deklarata nën betim e dorëzuar nga OE Alfa I.

**PRETENDIMI 4 – TRAJTIMI I GJETJEVE TË GOE ARCUMSTUDIO & MUHAMET MUÇIQI & BM GROUP & VIA EGNATIA SHPK Ky GOE është eliminuar me Vendim të PSH nr. 2024/0001 për arsye që nuk ka dëshmuar interesin material, pasi që nuk ka atakuar vendimin e AK-së në OSHP. Po ashtu, ky GOE është i papërgjegjshëm për arsyet e mëposhtme:**

1. Mungesa e Standardeve ISO: Nuk është dorëzuar për të gjithë anëtarët e grupit standardet ISO të kërkuara, siç janë ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, dhe ISO 45001:2015. Bazuar në Udhëzimin nr. 001/2023 dhe Rregulloren nr. 001/2023, Neni 26, paragrafi 26.6, të gjithë anëtarët e grupit duhet të kenë standardet ISO të kërkuara.
2. Deklaratat nën Betim: Deklaratat nën Betim të dorëzuara nuk e kanë të precizuar për cilin projekt apo cilin numër të prokurimit. Kjo nuk përmbush kërkesat e DT-së.
3. Plani Dinamik: Plani dinamik i dorëzuar nuk është në formë të rregullt, pasi është dorëzuar në format EXCEL dhe nuk është i vulosur e as i nënshkruar.
4. Kapaciteti Teknik dhe Profesional: o Punëtorët e Trajniruar: Nuk janë dorëzuar marrëveshjet mbi angazhimin e 30 punëtorëve fizikë të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë. Ky GOE ka dorëzuar vetëm Certifikata për siguri në vendin e punës, por nuk ka të bashkangjitur Certifikata për shëndet në punë. o Inxhinieri i Hidroteknikës: Inxhinieri i hidroteknikës i prezentuar ka përvojë prej 4 vjetësh pas diplomimit (diplomimi në qershor 2019), ndërsa kërkohej përvojë prej 5 vjetësh.
5. Specialisti i Mjedisit: Nuk është dorëzuar specialist i mjedisit, por vetëm një inxhinier i ndërtimit i cili nuk është licencuar për të bërë raporte mjedisore, ndryshe nga kërkesat e ligjit të Kosovës.
6. Materialet dhe Specifikimet: o Pos 11.5 dhe 11.7 nga BoQ: Prodhuesi i autorizuar nga ky GOE nuk ka të dëshmuar specifikat e kërkuara në katalog për këto pozita. o Pos 13.1: Katalogu dhe specifikat e izolimit termik (EPS & XPS) nuk kanë specifikat e kërkuara. o Pos 16.10: Nuk është prezentuar Test Raport për pllaka sipas standardit EN 12390-8. o Pos 23.2 dhe 23.4: Në katalogun e prezantuar nga prodhuesi V-TAC nuk ka produkte që përmbajnë specifikat e kërkuara për këto pozita. Përfundim: Materialet e prezentuara nga ky GOE nuk përmbushin specifikat e kërkuara në BoQ dhe DT, duke rrezikuar funksionimin e projektit. Prandaj, ky GOE me të drejtë është eliminuar pasi që nuk ka prezentuar Test Raport , i mungojn ISO dhe materialet e ofruara nuk përputhen me specifikat e kërkuara. Ju lutem referojuni tabelës së Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik, e cila është bashkangjitur te pretendimi 10.

**PRETENDIMI 5 – TRAJTIMI I GJETJEVE TË GOE LIMITPROJECT & DELTA & RINESA & ILEA-GR Ky GOE është eliminuar me Vendim të PSH nr. 2024/0001 për arsye se ka humbur**



interesin material, pasi nuk ka atakuar vendimin e AK-së në OSHP. Ky GOE është i papërgjegjshëm për arsyet e mëposhtme: 1. Kapaciteti Teknik dhe Profesional – Kërkesa 1: o Ky GOE nuk ka plotësuar kërkesën për të ofruar dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 4.5 milion euro në tre vitet e fundit. Ky GOE ka paraqitur lista të projekteve që përmbajnë referenca të përsëritura dhe që nuk arrijnë vlerën e kërkuar prej 4.5 milion euro, dhe disa referenca nuk janë të natyrës së njëjtë. 2. Plani Dinamik: o Ky GOE nuk ka dorëzuar planin dinamik të kërkuar në DT dhe që është pjesë e poentimit. Në formularin e tenderit është evidentuar 500 ditë punë, ndërsa në deklaratën për fillimin dhe përfundimin e kontratës është paraparë 600 ditë. Ky GOE ka dështuar të dorëzojë një plan dinamik të detajuar dhe dokumentacioni është në kundërtë me planifikimin e kryerjes së projektit. 3. Certifikatat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë: o Ky GOE nuk ka dorëzuar certifikatat e sigurisë dhe shëndetit në punë për 11 punëtorë, dhe ka dorëzuar vetëm certifikata për 16 punëtorë pa përfshirë certifikatat për shëndet në punë. Ky GOE është i papërgjegjshëm për faktin që nuk i ka 30 punëtorë të trajnuar sipas kërkesave të DT. 4. Standarde ISO: o Ky GOE nuk ka dorëzuar të gjitha standardet ISO të kërkuara, si ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, dhe ISO 45001:2015, për të gjithë anëtarët e grupit. Kjo është në kundërshtim me kërkesat e nenit 70 të LPP-së dhe nenit 26 paragrafi 26.6 të Rregullores nr. 001/2023 dhe Udhëzimit nr. 001/2023. 5. Materialet dhe Specifikimet: o Ky GOE nuk ka plotësuar kërkesat e DT-së lidhur me katalogët dhe specifikat e materialeve. Për çdo pozicion të renditur në BoQ, prodhuesi i autorizuar nga ky GOE nuk ka siguruar certifikata ISO të kërkuara dhe katalogët e prezantuar nuk përmbushin specifikat e kërkuara. Ja disa shembuj të gjetjeve: ▪ Pos 11.1 deri në 11.7 nga BoQ: Nuk janë prezantuar certifikata ISO dhe katalogë të kërkuar. ▪ Pos 12.11 deri në 12.18 nga BoQ: Nuk ka të prezentuar katalogë, certifikata ISO, as deklaratat të konformitetit. ▪ Pos 13.1: Nuk ka specifikat e izolimit termik (EPS & XPS) në katalog. ▪ Pos 16.10: Nuk është prezentuar Test Raport për pllaka sipas EN 12390-8. ▪ Pos 23.1 deri në 23.4: Nuk ka katalogë për këto pozita. ▪ Pos 26.5: Nuk ka autorizim, katalog, garancion, ose certifikatë ENEC. Përfundim: Materialet e propozuara nga ky GOE nuk përputhen me kërkesat e BoQ dhe DT, duke rrezikuar funksionimin e projektit. Prandaj, ky GOE me të drejt është eliminuar pasi nuk ka dorëzuar katalogë dhe materialet e prezentuara nuk përmbushin specifikat e kërkuara. Ju lutem referojuni tabelës së Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik, e cila është bashkangjitur në Pretendimin 10. Ju si Autoritet Kontraktues (AK) nuk e keni respektuar nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke na diskriminuar si operator ekonomik në mënyrë të pabarabartë, duke na eliminuar padrejtësisht me evidentimin e fakteve të rrejshme dhe manipulative. Edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Dokumentacionit të Tenderit (DT) dhe të njoftimit për kontratë, ne nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Po shihet se qëllimi juaj ka qenë që ne të mos shpallemi fitues, duke na eliminuar me disa arsye të pabaza dhe eliminuese, duke mos respektuar nenin 6, pasi kemi qenë ofertuesi më ekonomikisht të favorshëm dhe rekomanduar për kontratë në krahasim me një ofertues të papërgjegjshëm, në kundërshtim me nenet 59 dhe 60 të LPP-së. Ju si autoritet kontraktues na keni eliminuar në kundërshtim edhe me nenet 68 dhe 69 të LPP-së, pasi kemi plotësuar gjendjen ekonomike dhe financiare dhe aftësinë teknike/profesionale”.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

**Tenderi juaj eshte refuzuar për këto arsye :**

Juve si GOE-ik ju mungon garancioni për min. 1 vit nga prodhuesi për pozicionet sipas kërkesës nr. 6 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit. AK ka kërkuar nga OE sqarime shtesë sipas vendimit OSHP:2024/0001 të datës 15.04.2024. OE ka kthyer sqarime shtesë me ç'rast ka bashkangjitur autorizime nga prodhuesi ESADPANEL, Seferi Group, ZGSM Technology, Engoffice dhe Proklima. Megjithatë OE së bashku me ofertën e tij ka dorëzuar katalogjet e prodhuesve të tjerë siç janë V-TAC Europe, Halcor, Sinostar, Saint-Gobain, Eurofisi, ORCA, Mario Dorin, GREE, Reventon, Haier, etj. Pra OE ka dorëzuar katalogjet e prodhuesve të tjerë dhe ka dorëzuar autorizime nga krejt prodhues të tjerë. Prandaj OE nuk ka dorëzuar garancioin e prodhuesit për 1 vit sipas kërkesës nr. 6 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit.

Ju si GOE-ik me ofertën tuaj keni dorëzuar Planin dinamik qe nuk e plotëson kriterin e paraqitur në dosjen e tenderit për vitin 2023, 2024 dhe 2025, shih me poshtë:

Vlera e parashikuar	2.4	3,500,000.00 Buxheti për vitin 2023 - 1.400.000,00 Buxheti për vitin 2024 - 1.100.000,00 Buxheti për vitin 2025 - 1.000.000,00
---------------------	-----	---

2.1. OE Construmax ka paraqitur plan dinamik për 112 ditë dhe nuk është e përcaktuar që ky plan dinamik të bartet për vitet tjera sipas parashikimit në nenin 2.4 në DT dhe nuk ka të specifikuar që plani dinamik mund të bartet në vitet tjera.

3. Dyert e frigodhomave → pozicionet ne BoQ 12.11-12.18 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë te skeduar afatet.

4. Dritaret → pozicioni ne BoQ 12.1-12.10 → ISO 9001 e skaduar (01.04.2015) dhe certifikata vetem ne gjuhen polake.

5. VRF → pozicioni ne BoQ 29.11-30.1 → ISO 9001 e skaduar,\* autorizimi nuk është i dhënë as nga prodhuesi e as nga distributori i autorizuar ( është i dhënë nga Service provider),\*Certifikata e EUROVENT është e skaduar 31.07.2020, \*Ne autorizimin e prodhuesit (distributorit) nuk është e cekur titulli projektit, numri prokurimit si dhe nuk ka date te autorizimit.

6. Gypat për ujesjelles → pozicioni ne BoQ 17.8-17.10 → autorizimi nga distributori nuk ka date te leshimit.

7. Njësit për friza → pozicioni ne BoQ 28.1-28.14 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë te skeduar afatet (01.06.2022).

Komisioni i rivlerësimit bazuar ne rekomandimet e dhëna ne Vendimin e OSHP-se me nr: OSHP: 2024/0001 ka kërkuar sqarime shtese përmes letrës standarde B47 më datë 12.08.2024 dhe brenda afatit kohore te përcaktuar ne B47 GOE-ik është përgjigjur ne sqarime.

Komisioni i rivlerësimit është mbledhur dhe pas shqyrtimit te përgjigjeve te OE-ik komisioni konstaton se përgjigjet e dërguara të datës 14.08.2024 nga OE-ik nuk janë bindëse sipas DT-se, njofimit për kontrate, dhe ofertës se dorëzuar nga OE-ik.

**Andaj ne baze te arsyetimeve qe u dhanë më larte AK-se konstaton se ju nuk përmbushni kërkesat e AK-se dhe për këtë aktivitet te prokurimit jeni i papërgjegjshëm..**

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet sqaruar se kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është analizuar me kujdes dhe në tërësi. Me këtë rast është gjetur si vijon:

Për pozicionet 29.11 dhe 30.1 ju keni dorëzuar një katalog nga kompania kineze Haier Comercial Air Conditioning mirëpo nuk keni bashkangjitur fare autorizim të prodhuesit. Rrjedhimisht për këto dy pozicione nuk keni përmbushur kërkesën nr. 4 dhe 5 të kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes së tenderit. Në anën tjetër për pozicionet 29.11 dhe 30.1 ju keni dorëzuar një garancion të prodhuesit nga një kompani tjetër që është Engoffice. Përndryshe në këtë garancion nuk potencohet se ofrohet garancioni për 1 vit për pozicionet 29.11 dhe 30.1 por përmenden 4 pajisje të tjera me përshkrime të cilat nuk përkojnë me pozicionet përkatëse. Përndryshe, jo vetëm që mungon autorizimi i prodhuesit dhe katalogu nuk përputhet me garancion, por i njëjti nuk përputhet as me vet pozicionet përkatëse. P.sh në katalog askund nuk është arritur që gjendet rekupatori me përshkrimin si në poz. 29.11, etj. Pra ju nuk keni arritur që të përmbushni këtë kërkesë të dosjes së tenderit prandaj në këtë pikë keni dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën edhe jeni eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

2. Plani dinamik nuk e plotëson kriterin e paraqitur në dosjen e tenderit për vitin 2023, 2024 dhe 2025. OE Construmax ka paraqitur plan dinamik për 112 ditë dhe nuk është e përcaktuar që ky plan dinamik të bartet për vitet tjera sipas parashikimit në nenin 2.4 në DT dhe nuk ka të specifikuar që plani dinamik mund të bartet në vitet tjera.
3. Dyert e frigodhomave → pozicionet ne BoQ 12.11-12.18 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë te skaduara afatet.
4. Dritaret → pozicioni ne BoQ 12.1-12.10 → ISO 9001 e skaduar (01.04.2015) dhe certifikata vetem ne gjuhen polake.
5. VRF → pozicioni ne BoQ 29.11-30.1 → ISO 9001 e skaduar,\* autorizimi nuk eshte i dhene as nga prodhuesi e as nga distributori i autorizuar ( eshte i dhene nga Service provider),\*Certifikata e EUROVENT eshte e skaduar 31.07.2020, \*Ne autorizimin e prodhuesit (distributorit) nuk eshte e cekur titulli projektit, numri prokurimit si dhe nuk ka date te autorizimit.
6. Gypat per ujesjelles → pozicioni ne BoQ 17.8-17.10 → autorizimi nga distributori nuk ka date te leshimit.
7. Njesit per friza → pozicioni ne BoQ 28.1-28.14 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë te skaduara afatet (01.06.2022).

Vlen të thuhet se arsyet eliminuese me nr. 3, 4, 5, 6 dhe 7, parashtruesi nuk i konteston fare as me kërkesën për rishqyrtim. Prandaj këto të gjetura të komisionit vlerësues si të tilla mbesin të pakontestueshme.

Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë, duhet cekur se përderisa parashtruesi vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë.

Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmojë të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Përndryshe duhet shtuar edhe faktin që parashtruesi ka ofertuar me çmim dukshëm më të lartë sesa tenderuesi i rekomanduar për 354,545.45 euro më tepër sesa tenderuesi i rekomanduar).

Prandaj në rastin hipotetik më të favorshëm për parashtruesin, sërish parashtruesi në rast të rivlerësimit nuk do të mund të shpallej si tenderues i suksesshëm për shkak të çmimit dukshëm më të shtrenjtë (rreth 11% apo 354,545.45 euro më shtrenjtë) në krahasim me tenderuesin e rekomanduar por edhe kritereve tjera mbi të cilat tenderuesi i rekomanduar është dukshëm më i favorshëm ekonomikisht. Më konkretisht tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim prej 2,877,777.78 euro ndërsa parashtruesi ka ofertuar me çmim prej 3,232,323.23 euro përkatësisht me çmim rreth 11% apo 354,545.45 euro më shtrenjtë.

Megjithatë duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme dhe në përputhje të plotë me kërkesat e DT. Në fakt ofertat e tenderuesit të rekomanduar është oferta e përgjegjshme ekonomikisht më e favorshme por edhe me çmim më të lirë. Prandaj rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.09.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.